



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:157142

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05868473

P.nr. 176/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me sekretaren juridike Fatmire Podvorica si procesmbajtëse dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen penale kundër të pandehurit E. Sh., për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.808//2024, të datës 30.05.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 27.06.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Ardiana Veseli dhe i pandehuri, në të njëjtën ditë mori publikisht, shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

E. SH., i biri i M. dhe H. mbiemri i vajzërisë M., i lindur me dt....., me vendbanim në fshatin D. e P., ka të kryer shkollën fillore, i martuar baba i tre fëmijëve, i punësuar në kompanin "L.", me nr personal ... , i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

S E P S E

Më datën 05.01.2024, rreth orës 17:20, në pyllin me të cilin qeverisë Drejtorati për Bujqësi dhe zhvillim ekonomik-Autoriteti Pyjor Komunal P., në vendin e quajtur "K.", në Regjionin Ekonomiko-Pyjor të T., me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë duke prerë 217 copë trugje me sharr motorike, trugje të llojit bung, qarr, me dimensione 7 metra të gjata, diametër 10-12 cm, me vëllim të përgjithshëm 2,40 m3, me ç'rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në P. i ka shkaktuar dëm

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 81, 82, dhe nenit 349 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 242, 364, 365, 367,369, 452 dhe 462 të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

V Ë R E J T J E G J Y Q Ë S O R E

I. Me këtë vërejtje gjyqësore të akuzuarit E. SH, i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do t'i shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

II. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

III. E dëmtuara Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural nga P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën , PP.II.nr.808//2024, të datës 30.05.2024, kundër të pandehurit E. Sh., për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata ka treguar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 27.06.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, të njëjtit në kuptim të nenit 241 par.4 të KPPRK-së i ofrojë mundësinë e deklaramit të tij rreth fajësisë-të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri me rastin e deklaramit të saj rreth fajësisë për veprën penale për të cilën është akuzuar, në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se: E pranoj fajësinë, është e vërtetë si në aktakuzë, është e vërtetë se kam qenë në pyll për nevoja të familjes dhe se kam menduar se jam në pyll që është pronë e imja, drutë kanë qenë të thata, është hera e parë që jam në gjykatë, e lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë, ky rast nuk do të përsëritet, jetoj në kushte të vështira ekonomike jam baba i tre fëmijëve .

Gjykata vërteton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit ka dhënë mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe deklaroi se: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit , sepse i njëjti është bërë me vullnetin e plotë nga ana e të pandehurit dhe i bazuar në shkresat e lëndës.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par. 2 të KPPRK-së, aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri në shqyrtimin fillestar, andaj konform nenit 242 par. 6 të KPPRK-së vazhdoi me shqyrtimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i pandehuri, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit përmbushen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin e paraparë ligjor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit të sanksionit penal për të pandehurin, Gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, andaj vlerësoi se ky sanksion penal i shqiptuar të pandehurit është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një sanksion të tillë penal do të arrihet qëllimi i vërejtjes gjyqësore, i paraparë me nenin 81 të KPRK-së, me të cilin kryesit i jepet qortimi dhe i bëhet me dije se ka kryer vepër të dëmshme penale dhe të rrezikshme që përbënë vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, Gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPPRK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, për shkak se gjykata nuk ka pasur ndonjë ekspertizë nga ndonjë ekspert i pavarur për vlerësimin e dëmit, andaj mbi këtë bazë është udhëzuar në kontest civil, pasi që gjykata nuk ja fali besimin, vlerësimin e dëmit vetëm nga pala e dëmtuar për shkak se nuk paraqet bazë të sigurt për gjykim.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr. 176/24, dt. 27.06.2024.

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.